



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2024:066331

Datë: 12.06.2024

Numri i dokumentit: 05814141

**P.nr.46/2024**

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – Dega në Skenderaj** - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Qëndresa Tahiri Islami, me bashkëpunëtoren profesionale Edita Koliqi, në lëndën penale ndaj të pandehurit: A.S, për shkak të veprave penale: Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par.1 të Kodit (Nr. 06/L-074) Penal të Republikës së Kosovës (*tutje si: KPRK*), Asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së dhe veprës penale Sulmi nga neni 184 par.2 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, sipas Aktakuzës PP/II.nr.298/24, të datës 07.05.2024 të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me datë 07.06.2024, në mungesë të palëve, me datë 10.06.2024 shpalli publikisht, ndërsa më datë 12.06.2024, e përpiloi këtë:

### A K T G J Y K I M

#### I pandehuri:

**A.S** me nofkën ....., nga i ati ....., e ëma ....., e vajzërisë ....., i lindur më ....., në fshatin Burojë, Komuna Skenderaj, me vendbanim në rrugën “.....”, ndërtesat e “.....”, banesa nr....., Skenderaj, beqar, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal ....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### ËSHTË FAJTOR

#### I

#### SEPSE:

Me datë 24.02.2024, rreth orës 03:00, në rrugën “Fehmi dhe Xhevë Lavdrovci”, ndërtesat e “Rukollit”, lamela II, banesa nr.4. Skenderaj, i pandehuri me dashje ndez zjarrin në banesën në

të cilën jeton – pronë e prindit të tij, ashtu që me anë të një shkrepëse ndez zjarrin brenda në dhomën e fjetjes në fund të korridorit e cila dëmtohet tërësisht nga zjarri, së bashku me orenditë dhe mobilet, po ashtu dëmtohen muret dhe tavani, dhomat tjera, banjo, korridori dhe siguresat e rrymës nga zjarri dhe tymi, gjithashtu edhe korridori i objektit banesor dëmtohet nga tymi, ku si pasojë e kësaj shkakton rrezik të madh për jetën e njerëzve dhe dëm material, ashtu që personat në banesat fqinje ishin në gjumë dhe kishte rrezik që të ngulfaten nga tymi, e të cilët me ndihmën e Policisë së Kosovës janë larguar përmes dritareve pasi që korridoret ishin të pakalueshme për shkak të tymit të madh.

- Me këtë ka kryer veprën penale: Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par.1 të KPRK-së.

## II

Me datë 18.02.2024 dhe 19.02.2024, në rrugën “Fehmi dhe Xhevë Lavdrovci”, ndërtesat e “Rukollit”, lamela II, Skenderaj, i pandehuri me dashje dëmton dyert e hyrjeve të banesave në këtë objekt, ashtu që me përdorimin e thikës dëmton dyert e banesës numër një (1) e cila është e pabanueshme duke e gërvishtur si dhe duke ja hequr numrin, numër (2) pronë e të dëmtuarit E.V të cilën e gërvisht me thikë, numër (3) pronë e të dëmtuarit A.A, të cilën e gërvisht me thikë dhe ja heq numrin, numër (5) të cilën e gërvisht me thikë dhe ja heq numrin si dhe numër (6) të cilën e gërvisht me thikë, e shtyp pjesën ballore dhe ja heq numrin.

-Me këtë ka kryer veprën penale: Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së.

## III

Me datë 10.05.2024, rreth orës 16:30, në rrugën “Fehmi dhe Xhevë Lavdrovci”, Skenderaj, gjegjësisht në furrën “Lindi”, i pandehuri me dashje ka tentuar të sulmojë të dëmtuarin N.Z, në atë mënyrë që kishte shkuar në furrën në fjalë dhe me të hyrë aty kishte filluar të shaj dhe të ofendoj, duke i mbajtur në duar dy thika, ku i dëmtuari kishte tentuar ta qetësojë dhe gjatë kësaj kohe i pandehuri tenton ta godas me thika, duke i shkaktuar frikë të dëmtuarit, punëtorëve dhe klientëve prezent.

-Me këtë ka kryer veprën penale: Sulmi nga neni 184 par.2 lidhur me nenin 28 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata në bazë të neneve: 1, 4, 7, 17, 21, 38, 40, 42, 69, 71, 72,76, 78 lidhur me nenin 356, 321 dhe 184 të KPRK-së, dhe neneve: 364, 449, 452, 462 të KPP-së, të pandehurin, e:

## **G J Y K O N**

Për veprën penale si në pikën I:

-**DËNIM ME BURGIM** në kohëzgjatje prej pesë (5) muajve, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Për veprën penale si në pikën II:

-**DËNIM ME BURGIM** në kohëzgjatje prej tre (3) muajve, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Për veprën penale si në pikën III:

-**DËNIM ME BURGIM** në kohëzgjatje prej pesë (5) muajve, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Gjykata, në mbështetje të nenit 76 të KPRK-së, të pandehurit Arben Salihu, i:

## **S H I P T O N**

-**DËNIM UNIK njembëdhjet (11) muajve**, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

-**NDËRPRITET MASA E PARAGURGIMIT** dhe i njëjti lirohet të mbrohet në liri nga data 10.06.2024.

-Të pandehurit Arben Salihu, koha e kaluar në masën e paraburgimit nga data 24.02.2024 e deri me datë 10.06.2024 i llogaritet në dënimin e shqiptuar unik me burgim.

- Obligohet i pandehuri, që t'i paguajë shpenzimet e procedurës gjyqësore dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 (njëzetë) euro, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20 (njëzetë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

-Palët e dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore – juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil.

Gjykata në bazë të neneve 18 par.2, 84, 86 të KPRK-së dhe neneve 507, 514, 515 të KPP-së ku përfshihen kryerësit me çrregullime mendore, të pandehurit i shqipton:

## **MASËN E TRAJTIMIT TË DETYRUAR PSIKIATRIK NË LIRI**

-Masa e trajtimit të detyruar psikiatrik në liri do të ekzekutohet në Qendrën e Shëndetit Mental në Mitrovicë. I pandehuri obligohet që t'i nënshtrohet trajtimit të detyruar psikiatrik dhe të paraqitet ne këtë institucion sipas kohës, terminëve dhe rekomandimit të mjekëve, gjithashtu të përdorë terapinë sipas rekomandimit të doktorëve të kësaj Qendre. I pandehuri duhet te paraqitet tek ky institucion, në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

-Masa e trajtimit të detyruar do zgjasë për aq kohë sa është nevojshme për trajtimin e të pandehurit, por jo më gjatë se 3 (tre) vjet.

-Qendra e Shëndetit Mental në Mitrovicë, obligohet ta pranojë në trajtim të pandehurin sipas këtij aktgjykimi si dhe t'i dërgoi gjykatës raport mbi gjendjen shëndetësore dhe suksesin e trajnimit për të pandehurin. Qendra obligohet t'i raportoj gjykatës së paku njëherë në dy muaj dhe të njoftojë gjykatën për çdo vështirësi në trajtim.

-I pandehuri paralajmërohet se në rast mosrespektimit të kësaj mase të shqiptuar, se në rast se nuk merre pjesë ne trajtim, refuzon apo kanoset që të kryej ndonjë vepër tjetër penale, në këto raste gjykata mund të vendosë për ndërrimin e masës dhe shqiptimin e masës së trajtimit të detyruar me ndalim.

## **A r s y e t i m i**

### Aktakuza:

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.298/24, të datës 07.05.2024, ndaj të pandehurit A.S, për shkak të veprave penale: Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par.1 të KPRK-së, Asgjësim apo dëmtim i

pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së dhe veprës penale Sulmi nga neni 184 par.2 lidhur me nenin 28 të KPRK-së.

Me datë 07.06.2024, gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor, në praninë e palëve, prokurorit të shtetit në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, Albana Parduzy, të dëmtuarëve I. Sh dhe E.V, ekspertit të psikiatrisë Dr.Shpend Haxhibeqiri, si dhe të pandehurit A.S me avokatin mbrojtësi sipas detyrës zyrtare, av.Esat Syla.

Gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor, eksperti i psikiatrisë Dr.Shpend Haxhibeqiri, ka theksuar rëndësinë dhe domosdoshmërinë e trajtimit të rregullt psikiatrik për të pandehurin. Në deklaratën e dhënë ka konfirmuar se i pandehuri, në këtë rast i ekzaminuari A.S vuan nga një sëmundje kronike psiqike e quajtur Skizofreni Paranoide e cila kodohet me shifrën F20, kështu duke konstatuar se i pandehuri në momentin e kryerjes së veprës penale, aftësia e tij për ta kuptuar rëndësinë e veprës dhe kontrollimin e veprimeve të tij ka qenë e zvogëluar në shkallë esenciale. Ndër të tjera ka theksuar se i pandehuri është i gatshëm për gjykim, aktualisht kupton benifitet dhe pasojat e pranimin të fajësisë, e në bazë të ekzaminimit të bërë që ka ardhë deri në përfundimim e ekspertizës, ka rekomanduar që ndaj të pandehurit të i shqiptohet masa e Trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri në Qendrën e Shëndetit Mendor më të afërt me vendbanimin e të pandehurit.

I pandehuri, gjatë kësaj seancën të shqyrtimit gjyqësor, pas njoftimit nga gjykata, me të drejtat e tij në këtë fazë të procedurës penale, është deklaruar dhe ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet sipas aktakuzës së prokurorisë.

*Pretendimet e palëve gjatë shqyrtimit gjyqësor:*

Prokurori i shtetit Albana Parduzy, fillimisht i propozoi gjykatës që pranim e fajësisë të deklaruar nga i pandehuri ta miratoj, meqenëse nga deklaratimet e ekspertit i pandehuri është i aftë për të kuptuar rëndësinë e pranimin të fajësisë dhe pranimi i fajësisë ka mbështetje në faktet që përmban aktakuza. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka theksuar që të pandehurin gjykata ta shpall fajtor për veprën penale të kryer, ta dënoj sipas ligjit me një dënim me të cilin do të arrihet qëllimi i dënimit, duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese dhe njëkohësisht edhe masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri.

Të dëmtuarit I.Sh dhe E.V, nuk kanë dëshiruar të deklarohen sa i përket pranimin të fajësisë nga ana e të pandehurit A.S, ndërsa kanë mbështetur fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit.

Mbrojtësi i të pandehurit A.S, av.Esat Syla, ka propozuar që të miratohet pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit. Në fjalën përfundimtare ka deklaruar që të pandehurit të i shqiptohet një dënim sa më i butë, kjo duke pasur parasysh që pranimi i fajësisë është rrethënë lehtësuese, e po ashtu propozoi që ndaj të njëjtit të i shqiptohet edhe masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri.

### Gjetjet e Gjykatës:

Gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilin e ka deklaruar i pandehuri A.S, në mbështetje të nenit 242 të KPP-së, ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore për miratimin e pranimin të fajësisë për të pandehurin. Gjykata gjen se pranimi i fajësisë nga i pandehuri mbështetet në tërësi në provat që përmban kjo akuzë, siç janë: Procesverbali për marrjen në pyetje të dëmtuarit – dëshmitarit Isuf Shala në SP Skenderaj, i datës 24.02.2024; Procesverbali për marrjen në pyetje të dëmtuarit – dëshmitarit S.A në SP Skenderaj, i datës 24.02.2024; Procesverbali për marrjen në pyetje të dëmtuarit – dëshmitarit E.V në SP Skenderaj, i datës 24.02.2024; Raporti i oficerit Lulzim Hasani #7268, me numër 2024-BF-0086, i datës 24.02.2024; Dosja e forenzikës me numër të rastit 2024-BF-0086 dhe numër të dosjes së forenzikës 24-018, e datës 24.02.2024, së bashku me fotoalbumin me 41 fotografi; Raporti për gjendjen e shëndetit mendor për të pandehurin nga IFPK (Instituti i Psikiatrisë Forenzike të Kosovës) me numër të protokollit 100/2, i datës 30.04.2024; Ekspertiza mbi shkaktimin e rrezikut të përgjithshëm e datës 28.02.2024, e punuar nga eksperti inxh.dip.elek. Azem Neziri; Procesverbali për intervistimin e të pandehurit A.S në SP Skenderaj, i datës 24.02.2024, Procesverbali për marrjen e deklaratës së të pandehurit Arben Salihu në PTH Mitrovicë, i datës 01.09.2023; Procesverbali për marrjen në pyetje të dëmtuarit – dëshmitarit N.Z në SP Skenderaj, i datës 10.05.2022; Raportet për konsultat mjekësore për të pandehurin; Katër fotografi nga vendi i ngjarjes; Procesverbali për intervistimin e të pandehurit A.S në SP Skenderaj, i datës 25.04.2023; Procesverbali për marrjen në pyetje të dëmtuarit – dëshmitarit E.V në SP Skenderaj, i datës 18.02.2024; Raporti i oficerit Zenë Kadrija #8131, me numër 2024-BF-0082, i datës 19.02.2024; Raporti i oficerit Mentor Veliu #5184, me numër 2024-BF-0082, i datës 19.02.2024; Dosja e forenzikës me numër të dosjes së hetimeve 2024-BF-0082 dhe numër të dosjes së forenzikës 2024-TK-31, e datës 18.02.2024; Fotoalbumi me numër të dosjes së hetimeve 2024-BF-0082 dhe numër të dosjes së forenzikës 2024-TK-31, e datës 18.02.2024, që përmban 31 fotografi; Fotoalbumi me numër të dosjes së hetimeve 2024-

BF-0082 dhe numër të dosjes së forenzikës 2024-TK-31, e datës 18.02.2024, që përmban 27 fotografi; Procesverbali për intervistimin e të pandehurit A.S në SP Skenderaj, i datës 19.02.2024. Të gjitha këto prova janë bindëse dhe formojnë në tërësi elementet inkriminuese, e që në bazë të tyre dhe pranimit të fajësisë nga i pandehuri, përtej çdo dyshimi vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprat penale: Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par.1 të KPRK-së, Asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së dhe veprën penale Sulmi nga neni 184 par.2 lidhur me nenin 28 të KPRK-së.

Gjykata pas dëgjimit të mendimit të ekspertit në seancën e shqyrtimit gjyqësor është bindur se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe ka gjetur se pranimi i fajësisë nga i pandehuri është bërë në mënyrë vullnetare, pasi që ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë. Gjykata ia kishte tërheq vërejtjen të pandehurit se pas pranimit të fajësisë nuk mundet të shfrytëzojnë të drejtën në ankesë, lidhur me bazën për gjendjen faktike, i njëjti është njoftuar se nëse e pranon fajësinë humb mundësinë e kundërshtimit të provave në aktakuzë dhe mundësinë për paraqitjen e provave tjera, si dhe për faktin se pranimi i fajësisë sipas ligjit është një rrethanë lehtësuese që me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata mund të shqiptoj një dënim më të butë. Gjykata gjithashtu ka vërtetuar se aktakuza në këtë rast nuk përmban asnjë shkelje ligjore e as ndonjë gabim faktik dhe nuk ka bazë për hedhjen e akuzës.

Gjykata bazuar në pranimin e fajësisë nga i pandehurit dhe mbi bazën e provave të cekura si më lartë, përtej çdo dyshimi ka vërtetuar se i pandehuri A.S është përgjegjës për veprat penale për të cilat akuzohet: Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par.1 të KPRK-së, Asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së dhe veprën penale Sulmi nga neni 184 par.2 lidhur me nenin 28 të KPRK-së.

Matja e llojit dhe lartësisë së dënimit:

Gjykata, lidhur me caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin A.S, ka vlerësuar rrethanat për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 të KPRK-ës, e si rrethanë rënduese, gjykata ka vlerësuar shkallën e përgjegjësisë penale, intezitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur dhe rrethanat e kryerjes së veprave penale, pasi që me veprimet të tij ka shkaktuar rrezik të përgjithshëm, kështu që ka vënë në rrezik jetën e njerëzve, e që ka zjarri i shkaktuar ka pasur rrezik që njerëzit që janë banor të ndërtesës ku edhe ka ndodhur zjarri të ngulfaten na tymi, e që të njëjtin janë larguar përmes dritareve me ndërhyrjen e Policisë së Kosovës, po ashtu si rrethanë rënduese gjykata vlerësoi sjellën e mëparshme të pandehurit, pasi

që i njëjti edhe më parë ka qenë subjekt i procedurës penale, ndërsa rrethana tjera rënduese nuk ka gjetur.

Ndërsa si rrethanë lehtësuese, ka marrë për bazë faktin se i njëjti ka treguar sjellje të mira, ka bashkëpunuar plotësisht me organet e rendit dhe drejtësisë që nga fillimi i procedurës kundër tij, duke kontribuar kështu në zbardhjen e shpejtë dhe të plotë të këtij rasti. Ndërsa, si rrethanë posaçërisht lehtësuese për të pandehurin është vlerësuar pranimi i fajësisë në tërësi për veprat e kryera penale.

Gjykata, në kuptim të nenit 71 të KPRK-së ka aplikuar dispozitat e zbutjes së dënimit sa i përket veprave penale Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par.1 të KPRK-së dhe veprës penale Sulmi nga neni 184 par.2 të KPRK-së, duke u bazuar në faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë dhe se pranimi i fajësisë është rrethanë ligjore, në kuptim të nenin 71 par.1, nën-par.1.3 të KPRK-së, që gjykata të shqiptojë dënim nën minimumim e dënimit të paraparë për këtë veprë. Megjithatë, me rastin e zbutjes së dënimit, janë respektuar kufijtë e zbutjes sipas nenit 72 par.1, nën-par. 1.6 të KPRK-së, që në rastet e tilla, kur minimumi i dënimit për veprën penale është me më pak se një (1) vit, dënimi mund të zbutet deri në tridhjetë (30) ditë burgim.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se, shqiptimi i dënimit unik me burgim, ndaj të pandehurit është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Po ashtu, gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 par.1 të KPRK-së, që t'i parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se, shqiptimi i dënimit unik me burgim, ndaj të pandehurit është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Po ashtu, gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 par.1 të KPRK-së, që t'i parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.



*Ndërprerja e masës së paraburgimit:*

Gjykata, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ashtu që të pandehurit ia ka ndërprerë masën e paraburgimit, me rastin e shpalljes së aktgjykimit. Në lidhje me këtë Gjykata ka lëshuar vendim të veçantë ku edhe i ka dhënë arsyet për një vendim të tillë.

Po ashtu të pandehurit kohën e kaluar në masën e paraburgimit, nga data 24.02.2024 e deri me datë 10.06.2024, ia ka llogaritur në dënim e shqiptuar unik me burgim, kjo duke u bazuar në nenin 79 të KPRK-së, ku përcaktohet se çdo periudhë e heqjes së lirisë lidhur me veprën penale llogariten në dënimin e shqiptuar me burgim.

*Kërkesa pasurore juridike:*

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit, dhe të dëmtuarit i ka udhëzuar në kontest të rregullt juridiko – civil në kuptim të nenit 462 të KPP-së.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e procedurës dhe ato për paushall gjyqësor. Ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 39 par. 3 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

*Masa e trajtimit të detyrueshëm në liri:*

Gjykata ndaj të akuzuarit ka shqiptuar edhe masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri, duke u bazuar në nenin 86, par.1, të KPRK-së, pasi që ekziston rreziku serioz se i akuzuari do të kryej vepër tjetër, se ky trajtim është i nevojshëm për të shmangur kryerjen e veprës tjetër penale, e po ashtu se ky trajtim është i mjaftueshëm për të shmangur rrezikun serioz. Gjykata konstaton se bazuar në ekspertizën psikiatrike, në rastin konkret kemi të bëjmë me person i cili vuan nga çrregullimi mendor i quajtur Skizofreni Paranoide çrregullim i cili në Klasifikimin Ndërkombëtarë të Sëmundjeve (ICD-10) kodohet me shifrën F 20.0, andaj edhe për shkak të këtyre çrregullimeve ka rrezik që të kryej vepër tjetër penale apo edhe trajtimi është i nevojshëm për të shmangur rrezikun për vepra tjera. Prandaj, gjykata e shqiptoj këtë masë në liri si masë adekuate dhe të përshtatshme për trajtimin e të pandehurit kohë pas kohe kur ai ka nevojë për një trajtim të tillë, dhe se kjo masë do të jetë në interes të pandehurit. Kjo masë do të zbatohet në Qendrën e Shëndetit Mental në Mitrovicë, institucion ky i propozuar nga ekspertiza psikiatrike.

Masa e trajtimit të detyruar psikiatrik në liri do të zgjasë derisa institucioni shëndetësor përgjegjës për shërimin mendor të konstatojë se më nuk është e nevojshme kjo masë. Ndërsa kufizimi që nuk mund të zgjasë më shumë se 3 vjet, është bazuar në nenin 86, par.4, të KPRK, ku parashihet se trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri nuk mund të zgjasë më shumë se tre vjet nëse i është shqiptuar kryerësit me aftësi esencialisht të zvogëluar mendore. Ndërsa në kuptim të nenit 86, par.5, të KPRK-së, i akuzuari është paralajmëruar se në rast se nuk e zbaton vullnetarisht masën, e braktisë trajtimin apo kanoset se do kryejë veprë tjetër, gjykata do t'ia zëvendësoj trajtimin në liri me masë e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin përkatës shëndetësor.

Andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 358, 364, 449, 452, 462, 507, 514, 515 të KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – Dega në Skenderaj**

### **Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal**

**P.nr.46/2024, datë 12.06.2024**

**Bashkëpunëtore profesionale**

**Edita Koliqi**

**Gjyqtarja e vetme gjykuese**

**Qëndresa Tahiri - Islami**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.